

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

BURIME NJERËZORE

Ne baze te ligjit te Agjencise te Trajtitimit te Kredive dhe rregullores se saj

Kërkesat e veçanta për perzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar ;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- të ketë kryer studimet e larta Bachelor/Master
- të ketë pervoje pune me shume se 1 vit ne administraten publike ose në sektorin privat / ose në shërbimin përmbartimor
- të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- zoterimi i nje gjuhe te huaj perben avantazh
- të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup.

Përgjegjësitë

Burimet Njerëzore:

- Merr masa për zbatimin në kohë dhe me korrektësi të vendimeve dhe urdhërave të Drejtorit të Përgjithshëm.
- Njofton me shkrim Drejtorin e Përgjithshëm për çdo parregullsi dhe shkelje që konstaton dhe që bie ndesh me Rregulloren e Brendshme të ATK-së, duke përcaktuar edhe përgjegjësinë përkatëse.
- Merr me firmë dhe ezauron brenda afateve nga zyra e protokollit korrespondencën përkatëse.
- Organizon menaxhimin e burimeve njerëzore të ATK-së, rekrutimin e punonjësve të rinj për marrjen në punë dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm ristikutimin organizativ të institucionit sipas propozimeve të bëra nga strukturat e ndryshme të ATK-së.
- Ndjek dhe zbaton kriteret dhe rregullat e marrjes në punë në përputhje me Ligjin organik të ATK-së, Kodin e Punës dhe aktet e tjera normative për këtë qëllim.
- Bën sistemimin e dokumentave të depozituara nga kandidatët për t'u punësuar në ATK, të cilat ja paraqet Drejtorit të Përgjithshëm.
- Ruan me përgjegjësi të gjithë informacionin që i përket dosjes së çdo punonjësi apo çdo informacion tjetër që përpunohet nga ky sektor.
- Mban dhe plotëson regjistrin themeltar të punonjësve.
- Përgatit dhe firmos çdo muaj listë-prezencën e personelit të ATK-së që i bashkëlidhet listë-pagesës mujore.
- Përgjigjet për disiplinën në punë, respektimin e orarit zyrtar të punës si dhe kontrollon dhe raporton tek Drejtori i Përgjithshëm çdo shkelje të rregullave të sjelljes dhe etikës nga personeli i ATK-së duke propozuar dhe masa disiplinore.

- Ndjek zbatimin e masave disiplinore të dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm.
- Organizon procesin për vlerësimin vjetor të rezultateve të punës së punonjësve të ATK-së.
- Ndjek shpërndarjen dhe plotësimin e deklaratave të pasurisë për personat që e kanë detyrim ligjor në institucion.

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit :

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Kërkesë me shkrim
- Curriculum vitae
- Libreza e punes
- Dëshmi Penaliteti

Aplikimet duhet të dërgohen në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Agjensia e Tratjimit të Kredive

Njësia Administrative nr.5, Tiranë Rruga “Dora D’Istria”, Ndërtesa 22 Hyrja 1. Kodi 3771821017

Afati

Aplikimet prahen deri në date 08 Korrik 2022 ora 12:00. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumentave vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.